

VENDIM
Nr.343, datë 27.4.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTORE QË DO TË
PROKUROJNË, ME PROCEDURË ME NEGOCIIM PA SHPALLJE, MALLRA OSE
SHËRBIME TË NEVOJSHME PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË SHKATUAR
NGA COVID -19**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr.14, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të administrojë çdo shprehje disponibiliteti të paraqitur nga operatorët ekonomikë, të referuar si “biznesi i përpunimit aktiv”, sipas parashikimeve të Kodit Doganor, që prodhojnë mallra ose ofrojnë shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19.

2. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të hartojë dhe do të përditësojë listën e operatorëve ekonomikë, “biznesi i përpunimit aktiv”, të cilët shprehin disponibilitetin e tyre pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, çmimet përkatëse të mallrave e të shërbimeve, si dhe kohën për lëvrimin e mallrave apo ekzekutimin e shërbimeve.

3. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, bazuar në kërkesën e çdo autoriteti kontraktor, do të vendosë në dispozicion, menjëherë listën e përditësuar të operatorëve ekonomikë “biznesi i përpunimit aktiv”, që kanë shprehur disponibilitetin për mallrat dhe shërbimet e nevojshme, për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19.

4. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, ngarkohet me zhvillimin e procedurave të prokurimit, me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, për fondet me vlerë mbi ose nën kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrit, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për plotësimin e nevojave emergjente të autoriteteve kontraktore dhe lidhjen e kontratave publike nga ana e tyre për mallra dhe shërbime të nevojshme, për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj, për objektet e prokurimit, si më poshtë vijon:

a) “Shërbime dezinfektimi”, të lidhura ngushtësisht dhe të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19, të ambienteve të brendshme dhe/ose të jashtme të autoriteteve kontraktore;

b) “Blerje materialesh të nevojshme për mbrojtjen personale” (maska, doreza, materiale pastrimi, dezinfektimi, alkool etj), të lidhura ngushtësisht dhe të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, për nevojat e punonjësve të autoriteteve kontraktore, përveç personelit shëndetësor.

5. Autoritetet kontraktore, sipas pikës 4, të këtij vendimi, duhet të dërgojnë në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për mallrat dhe shërbimet e nevojshme, për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 2 (dy) ditë nga njoftimi i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.

6. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara mund të zhvillojë procedura prokurimi sipas pikës 4, të këtij vendimi, edhe kur kërkohet nga një autoritet a një grup autoritetesh kontraktore, të cilat nuk janë përcaktuar në këtë vendim.

7. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, bazuar në specifikime teknike/terma reference të unifikuar të mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, të evidentojë çmimet normale të tregut, me qëllim krahasimin e tyre me çmimet e mallrave dhe shërbimeve përkatëse, të paraqitura nga operatorët ekonomikë “biznes i përpunimit aktiv”, sipas parashikimeve të nenit 2, të aktit normativ nr.14, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave.

8. Mallrat dhe shërbimet do të konsiderohen të leverdisshme kur disponibiliteti i operatorëve ekonomikë është paraqitur për çmime më të ulëta se çmimet normale të tregut dhe për kohë lëvrimi të mallrave apo ekzekutimi të shërbimeve, më të shkurtra se afatet e kërkuara nga autoritetet kontraktore.

9. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, për mallrat dhe shërbimet e përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Të bashkërendojë punën me autoritetet kontraktore për mbledhjen e përpunimin e të dhënave, teknike e sasiore, të mallrave dhe shërbimeve, objekt prokurimi;

b) Të verifikojë përputhshmërinë e kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore, me specifikimet teknike / termat e referencës të unifikuar, si dhe përlllogaritjen e fondit bazuar në çmimet normale të tregut;

c) Të vlerësojë nëse lista e operatorëve ekonomikë “biznes i përpunimit aktiv”, që kanë shprehur disponibilitetin, ka oferta të leverdisshme në vlerë dhe në kohë, sipas përcaktimeve në pikën 8, të këtij vendimi;

ç) Të fillojë kryerjen e procedurave të prokurimit, me paraqitjen e çdo kërkesë nga një autoritet a një grup autoritetesh kontraktore;

d) Të zhvillojë procedurat për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, deri në shpalljen e fituesit;

dh) Të njoftojë autoritetet kontraktore që të lidhin kontratë.

10. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, gjatë verifikimit të kërkesave të dërguara nga autoritetet kontraktore në drejtim të përputhshmërisë me specifikimet teknike / termat e referencës të unifikuar apo të përlllogaritjes së fondit bazuar në çmimet normale të tregut, mund të ndryshojë ose të saktësojë të dhënat teknike e sasiore, duke njoftuar autoritetet kontraktore për këto ndryshime, përpara fillimit të procedurës. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara mund të kërkojë ndihmën e një apo disa autoriteteve kontraktore, si dhe duhet t’u sigurojë këtyre të fundit, sa herë që e kërkojnë, akses të plotë në çdo informacion për procedurën e prokurimit.

11. Me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit për plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore dhe lidhjen nga ana e tyre të kontratave publike, për mallrat dhe shërbimet e nevojshme për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19, të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të ftojë dhe do të negociojë me operatorët ekonomikë “biznes i përpunimit aktiv”, që kanë shprehur disponibilitetin e tyre për këto mallra ose shërbime, të vlerësuara të leverdisshme në vlerë dhe në kohë.

12. Nëse operatorët ekonomikë “biznes i përpunimit aktiv” nuk do të shprehin disponibilitetin, ose nuk do të ofertojnë, ose nuk do të mundësojnë plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore me mallrat ose shërbimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të ftojë dhe do të negociojë me operatorë të tjerë ekonomikë, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit, me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, për plotësimin e nevojave emergjente të krijuara nga epidemia COVID-19, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

13. Çdo autoritet tjetër kontraktor, që nuk ka detyrimin të paraqesë kërkesë për prokurim në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, vijon me kryerjen e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, duke ftuar dhe negociuar me operatorët ekonomikë “biznes i përpunimit

aktiv”, që kanë shprehur disponibilitetin e tyre për mallra ose shërbime të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, të cilat vlerësohen të leverdisshme në vlerë dhe në kohë, për çmime më të ulëta se çmimet normale të tregut dhe për kohë lëvrimi të mallrave apo ekzekutimi të shërbimeve më të shkurtra se afatet e kërkuara nga këto autoritete kontraktore.

14. Nëse operatorët ekonomikë “biznes i përpunimit aktiv”, nuk do të shprehin disponibilitetin, ose nuk do të ofertojnë, ose nuk do të mundësojnë plotësimin e nevojave të autoriteteve kontraktore, me mallrat ose shërbimet e nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga COVID-19, autoritetet kontraktore do të vijojnë prokurimin e nevojave të tyre, në përputhje me parashikimet në legjislacionin e prokurimit publik në fuqi.

15. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia e Prokurimit Publik të udhëzojnë autoritetet kontraktore zbatuese të këtij vendimi për listën e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID-19, me të dhënat teknike e cilësore të tyre si dhe Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe institucionet e përmendura në pikën 4, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama